

Përshëndetje,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka administruar me e-mail kërkesen tuaj datë 04.10.2021.

Në lidhje me pyetjet tuaja ju sqarojmë si vijon:

1. Cilat janë mekanizmat detyrues që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka për të detyruar institucionet publike që të japin informacionin publik të kërkuar?

Bazuar në nenin 31/1 të ligjit nr 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka ndër të tjera kompetencë për:

- Shqyrtimin e ankesave të personave të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” (në vijim LDI);
- Kryerjen e hetimeve administrative;
- Vendosjen e sanksioneve administrative sipas parashikimeve të LDI.

Sa i takon procedurës së vënies në zbatim të mekanizmit detyrues, në bazë të nenit 24 të LDI: “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;*
- b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.*

Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. 5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:

- a) mospranimin e ankesës kur:
 - i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;*
 - ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;*
 - iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;**
- b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;*

- c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
- ç) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.

Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.

Bazuar në nenin 18 të LDI “Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”.

Per sa me siper, kompetenca e Komisionerit për të nxjerrë vendim urdhërimi për vënien në dispozicion të informacionit i cili mund të shoqërohet edhe me sanksion administrativ, përbën mekanizmin detyrues që parashikon ligji për detyrimin e autoriteteve publike për rritjen e transparencës dhe llogaridhenies.

- 2. Aktualisht gjoba e vendosur nga Komisioneri për të Drejtën e Informacionit nuk është titull ekzekutiv, çka do të thotë që mund të shkojë në proces gjyqësor ku mund të rrëzohet ose në përfundim të procesit të jetë e parashkruar. Sa ndikon mosqenia e kësaj gjobe titull ekzekutiv punën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit?**

Siç tashmë është e ditur, qasja e Zyrës së Komisionerit nuk ka qenë ajo ndëshkimore, por ajo edukuese dhe parandaluese. Problematika më e madhe ku meriton të vihet theksi aktualisht, nuk qëndron tek pjesa e ekzekutimit të sanksionit administrativ, por tek ekzekutimi i pjesës urdhëruese të vendimit për ekzekutimin e detyrimeve jo financiare (lidhur me dokumentacionin e kërkuar). Ky aspekt ka rezultuar problematik në praktikë dhe për këtë arsye, Zyra e Komisionerit do të propozojë që kjo pikë të përfshihet në ndryshimet ligjore të LDI.

- 3. A ka iniciativa për shndërrimin e kësaj gjobe në titull Ekzekutiv?**

Referuar dhe përgjigjes në pikën më sipër, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë një iniciativë për propozime në ndryshimin e LDI. Një nga këto ndryshime ka të bëjë me riformulimin e procedurës për shqyrtimin e ankesave, si dhe përcaktimi i vendimit të Komisionerit si titull ekzekutiv me kalimin e afatit të përcaktuar në Vendim.

- 4. Cfarë ndryshimesh ka nëse gjoba e vendosur nga Komisioneri shndërrohet në Titull Ekzekutiv për qytetarin?**

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 10297/2010 “Për kundravajtjet administrative”, “Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë”... “Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, të nxjerrë nga organi i administratës, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit”.

Për sa më sipër, gjoba e vendosur nga Zyra e Komisionerit shndërrohet në titull ekzekutiv nëse kundravajtësi nuk e ankimon në gjykatë brenda afatit të përcaktuar ose në rast se Gjykata e rrëzon padinë e ngritur nga ana e kundravajtësit.

Zyra e Komisionerit konsideron se do të ishte shndërrimi i vendimit për dhënien e informacionit të kërkuar në titull ekzekutiv ajo që do të rriste forcën detyruese të aktit dhe pasojat në rast mos ekzekutimit të tij.

5. Sa zgjat mesatarisht një proces në gjykatë ku kundërshtohet një gjobë e vendosur nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informacionit dhe sa është kostoja për përfaqësimin në gjykatë për Zyrën e Komisionerit?

Nga evidencat që disponojmë vlerësohet se koha mesatare e një procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë ku pala paditëse është personi i sanksionuar nga ana e Zyrës së Komisionerit, varion nga 2-6 muaj. Në raste të vecantë mund të tejkalohet ky afat kohor. Kosto totale në rast pranimit të padisë janë kostot administrative të burimeve njerëzore të Zyrës së Komisionerit për përfaqësim në gjykatë (orë pune të një punonjësi) si dhe shpenzimet gjyqësore të përcaktuara nga gjykata në rast të humbjes së procesit.

6. Cilat janë problemet kryesore që hasen në trajtimin e ankesave të qytetarëve, pasi kur shikon numrin e ankesave dhe me pas numrin e gjobave të vendosura nga Komisioneri kanë një diferenc të madhe?

Duke ju referuar të dhënave të publikuara në raportin vjetor 2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të cilin e gjeni të publikuar në këtë link https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/03/Raporti_IDP_2020.pdf raportohet se *gjatë këtij viti janë administruar 715 ankesa nga qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë investigativë, si dhe është vijuar shqyrtimi i 28 ankesave të mbartura nga viti 2019. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, për 472 prej tyre është vënë në dispozicion të ankuesit informacioni/dokumentacioni i kërkuar gjatë procesit të hetimit administrativ.*

Nga sa më sipër evidentohet se në më shumë se në 63% të ankesave që mbërrijnë pranë Zyrës së Komisionerit, qytetarët kanë marrë informacionin e kërkuar përgjatë kohës së ushtrimit të procesit administrative, duke bërë të mundur që të realizohet kërkesa e tyre për informacion, pa pasur nevojën e një vendimarrje nga ana e Komisionerit.

Për pjesën tjetër të ankesave Zyra e Komisionerit në raportin vjetor evidentohen se *për 35 ankesa Komisioneri është shprehur me Vendim, prej të cilëve 30 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 4 vendime rrëzimi dhe 1 vendim mospranimi.*

Ndërkohë, nga totali i ankesave të administruara, 24 rezultuan jashtë afatit, 13 ishin të paplota, 131 jashtë objektit, 23 u trajtuan sipas kufizimeve të nenit 17 të Ligjit për të drejtën e informimit, 1 ankesë është pezulluar dhe 44 u mbartën për shqyrtim në vitin 2021.

7. Cilat janë disa nga arsyet më të shpeshta të refuzimit të ankesave të bëra pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit?

Arsyet më të shpeshta të refuzimit të ankesave janë sipas përcaktimit të nenit 24 të LDI (i cituar në përgjigjen nr.1) dhe konkretisht nëse ankesa është e paplotë, jashtë objektit të LDI ose nëse informacioni i kërkuar përbën kufizim sipas përcaktimit të nenit 17 të LDI.

8. A ka të evidentuara Komisioneri për të Drejtën e Informimit se cilat janë institucionet më problematike për të Drejtën e Informimit? Nëse po ju lutem mund të na evidentoni disa prej tyre?

Zyra e Komisionerit nuk mban të dhëna statistikore të kësaj natyre por nga vendimet e dhëna ndër vite mund të evidentohen se në vite të ndryshme ka autoritete publike të ndryshme të cilat kanë zënë një pjesë të rëndësishme të vendimarrjes së Zyrës së Komisionerit. Në lidhje me vendimarrjen e Zyrës së Komisionerit mund ti gjeni në këtë link vendimet sipas viteve <https://www.idp.al/vendime-ddi/>

9. Në sa procese gjyqësore është aktualisht Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si palë e paditur? Për çfarë është paditur?

Më poshtë gjeni tabelën për listën e proceseve gjyqësore në të cilën Zyra e Komisionerit është palë e paditur

Nr. i Aktit 2526, datë 25.05.2021 Paditës: Bashkia Bulqizë I Paditur: KDIMDP	Shfuqizimin e pikës 1 dhe 2 të vendimit nr. 21 datë 09.04.2021 të Komisionerit për urdhërimin e AP.
Nr. i Aktit 2579, datë 08.06.2021 Paditës: L. D. I Paditur: KDIMDP	Shfuqizimin e pikes 3 te vendimit nr. 21 date 09.04.2021 te Komisionerit per te drejten e informimit dhe mbrojtjen e te dhenave personale.

Paditës: M. K. I Paditur: KDIMDP	Sigurim padie, lirim, dorezim sendi, shperblim demi kthim shume.
---	--